



Tirane, me 11 Shkurt 2016

Lenda: Relacion per çertifikimin e kultivarit te molles – FUJI dhe GALA

DREJTUAR

Vlash TIRANA

Drejtor i ESHFF Tirane

Mbeshtetur ne kerkesat e prodhuesve te fidanve te vendit tone dhe te takimeve te ndersjellta qe kemi bere ne kuadrin e aktivitetve te Ministrise Bujqesise, bashkengjitur do te gjeni relacioni per çertifikimin e kultivarit te molles FUJI.



Dr. Hafuz DOMI

Drejtor i ADAD Malore

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "H. Domi".

RELACION PER ÇERTIFIKIMIN E KULTIVARIT TE MOLLES FUJI

Nje historik i shkurtur i kultivarit Fuji ne vendin tone:

Kultivari Fuji eshte futur per here te pare ne Shqiperi ne vitin 2004 ne rajonin e Korces dhe te Dibres, i cili eshte sjelle nga Franca nepemjet organizates adad dhe Fert Paris. Me vone eshte futur nga Italia dhe Greqia nga disa prodhes qe eshte mbjelle ne siperfaqe te kufizuar. Ky kultivar eshte testuar per pershtashmerine, prodhimtarine ne fidanishten e Zemblakut Korce, ne disa pemetore ne Dvoran, Vranisht, Cangonj, Bilisht ne rajonin e Korces, Diber, Lushnje dhe Has. Rezultatet e arritura ne keto pemetore tregojne se Fuji ka zhvillim te mire vegjetativ, qendrushmeri te mire ndaj kromes dhe prodhimtari te larte qe arrin 500-650 kv/ha. Fruti eshte shume cilesor dhe i pelqyeshem konsumatori.

Perhapja:

Aktualisht me e perhapur eshte ne rajonin e Korces, ku jane ngritur shume pemetore te reja deri 0.5 ha, ndersa ne siperfaqe mjaft te kufizuara ne zonen fushore si Lushnje, Kavaje, Tirane, Diber etj. Ne Has eshte mbjelle per here te pare ne vitin 2011. Gjithesesi Fuji eshte i mbjelle ne siperfaqe te kufizuar, per rrjedhoje dhe prodhimi eshte i vogel dhe nuk perballon kerkesat e tregut vendas

Prodhimi dhe vlera ekonomike:

Ka mbi 3 vite qe Fuji njihet mire nga tregu shqiptar, eshte pelqyer dhe kerkohet shume nga konsumatori. Ky kultivar shitet nga prodhuesit me nje cmim rreth 10-15 leke/kg me shume se kultivaret e Goldit dhe Starkingt, ndersa ne treg shitet rreth 30 leke/kg me shume se kultivaret e tjere.

Problemi dhe propozimi :

Fuji shitet shume lehtesisht nga prodhuesit, por ka nje mosperputhje ndermjet prodhimit vendas qe eshte i vogel dhe kerkeses se tregut. Prandaj tregtaret e sjellin nga Italia me cmim shume te larte. Perballe ketij fakti eshte e nevojshme shtimi i pemetoreve me kultivarin Fuji. Prandaj del e nevojshme qe si fillim FUJI te futet ne katalogun e ESHFF per ti hap rruge prodhimit te fidaneve nga fidanishtet e vendit tone, te cilat kane kapacitetet e duhura per prodhimin e fidanve me kultivarin Fuji. Ne kete menyre prodhuesit u mundesohet blerja e fidaneve me cmime me te ulta, te shtojne siperfaqet dhe te rritet prodhimi si kerkese e tregut te sotem, per rrjedhoje kem nje hap cilesor ne prodhimin dhe tregun e molles.

CILESITE E KULTIVARIT FUJI – (FUXHI)

- Pema :** Origjina është Japonia dhe prindërit janë Red Delicious x Rall's Janet. Fuji është varietet me rritje të fuqishme, prandaj duhet të shartohet me neshartesa me rritje të dobët te grupit M9 me klonet e saj, kjo i lejon që të mbillet me dendesi të lartë nga 2000-3000 peme/ha. Pema ka tipin e kurorës si të Goldit dhe dominojnë dalja e degeve me kënd të gjere, të cilat japin frytezim të lartë dhe janë shumë të pershtashme për format e reja të kultivimit me dendesi të lartë.
- Lulezimi:** Pema lulëzon dy dite pas Gold Delicious dhe është e ndjeshme ndaj rrallimit në lulëzim. Ka prodhimtari të lartë dhe alternancë mesatare në prodhim.
- Pjalmimi:** Sherben si pjalmues dhe pjalmohet nga Gold, Starking, Granny Smith, Red Delicious
- Pamja e frutit :** Fruti është me formë të rrumbullakët - të shtypur, është heterogjen. Ka madhësi të mirë (75-80 mm), me ngjyrë dominante e kuqe-roze. Ngjyra e sfondit është jeshile - verdhë. Fruti është aromatik dhe me pamje tërheqëse.
- Shija e frutit :** Fruti është shumë i ëmbël, ka tul të fortë, kërcitës (krokant), i lëngshëm, shumë i vlerësuar për shije shumë cilësore dhe të vecantë dhe përmban 15 % sheqer.
- Pjekja ruajtja** Fruti piqet në mes Tetori në zonen e ftohtë dhe 1 javë para në zonen e ngrohtë. Fruti ruhet shumë mirë për 5-6 muaj. Prodhimi arrijnë nga 500-700 kv/ha.
- Komente :** Është varietet me rritje të fuqishme, prandaj duhet kujdes në krasitje, të bëhet krasitja e gjelbër dhe rrallimi që frutat të marrin ngjyrën karakteristike. Është i qëndrueshëm ndaj magazinimit. Duhet rrallim i mirë për të eliminuar periodicitetin. Është varieteti që ruan sheqerin dhe shijen për një periudhë të gjatë ruajtje.
- Vlerësimi :** Është varietet shumë i mirë, meriton përhapje në vendin tonë.

Pergatiti:

Dr. Hafuz DOMI

Drejtor i ADAD Malore



CILESITE E KULTIVARIT TE MOLLES - GALA

Pema: Është mutant i (Golden x Kidd'orange red). Pema qëndron me kurorë gjysmë e hapur me futjen në prodhim. Pema është me rritje mesatare në të fuqishme. Pemëtorja ka zhvillim të mirë dhe ka prodhimtari të lartë dhe të qëndrueshëm. Ka rrallim mesatarë dhe alternim të dobët.

Pamja frutit : Fruti është cipëlëmuar dhe me madhësi të mirë, me formë trung-konik, fruti është me ngjyrë të kuqe të shëndritëshme me vija të kuqe në portokall dhe me ngjyrim homogjen, ngjyrimi arrin në $\frac{3}{4}$ frutit, ka pamje të mirë dhe mjaft tërheqës.

Shija e frutit : Tuli është i fortë, kërcitës (krokant), i lëngëshëm, aromatik, i ëmbël i ekuilibruar në aciditet dhe shumë i shijshëm.

Fruti piqet në fillim gushti dhe vazhdon deri 15-30 gusht, ruhet mirë për 2-3 muaj.

Komente : Është e ndjeshme ndaj ngricave në lulëzim. Ka nevojë për rrallim sepse kemi rritje të shpejt të frutit dhe duhet të marrë ngjyrimin e duhur dhe jep fruta të cilësisë së lartë. Kujdes të mos kaloj koha e vjeljes sepse kemi çarje të tulit tek bishti.

Vlerësimi: Eshtë varietet shumë i mirë

Pergatiti: Dr. Hafuz DOMI

Drejtor i ADAD Malore

